



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1216/9 prot.

Datë 27.06.2025

V E N D I M

Nr.817/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.06.2025 me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38668-02-19-2025, me objekt “*Blerje materiale kancelarie, e ndarë në 3 (tre) lote*”, Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 83,205,946.00 Lekë pa TVSH, Numri i referencës së Lotit 2: REF-38672-02-19-2025 me objekt: “*Loti 2 - Blerje materiale Kancelarie të tjera zyre*”, me vlerë totale 13,757,377.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve për skualifikim të operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara, me adresë: Rruga “ReshitÇollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, me NIPT (L91418502J) dhe adresë Lagjja 13, pranë Shkollës 9 vjeçare Bajram Curri Durrës.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë ankimuar në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.02.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38668-02-19-2025, me objekt “Blerje materiale kancelarie, e ndarë në 3 (tre) lote”, Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 83,205,946.00 Lekë pa TVSH, Numri i referencës së **Lotit 2: REF-38672-02-19-2025 me objekt: “Loti 2 - Blerje materiale Kancelarie të tjera zyre”**, me vlerë totale **13,757,377.00 Lekë pa TVSH**, zhvilluar më datë 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 29.04.2025, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k	9,200,000	Skualifikuar
2. OE “OFFICE CENTER” sh.p.k	10,998,000	Skualifikuar
3. OE “InfoSoft Office” sh.p.k	13,679,698.70	Kualifikuar
4. OE “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k	13,700,301	Kualifikuar

II.3. Në datën 07.05.2025, autoriteti ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraprak për procedurën e prokurimit publik në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2025/5302, datë 09.05.2025 dhe nr. Protokolli 1216/2025, datë 12.05.2025, të operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38672-02-19-2025, me objekt: Loti 2 - Blerje materiale Kancelarie të tjera zyre”, me fond limit 13,757,377.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04-04- 2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.4.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1216/1 prot., datë 12.05.2025 lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK kundërshton, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.4.2. Më datë 19.05.2025, operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave, njëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 1216/2 prot., datë 19.05.2025.

II.4.3. Me shkresën nr. 632/23 prot., datë 20.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1216/3 prot., datë 21.05.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka refuzuar atë, me arsyetim si më poshtë:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson faktin, se shpjegimet për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e percaktuara në pikën 2 dhe 5 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në kuadër të detyrimit të metodës së përlogaritjes së ofertës ekonomike anomalisht të ulët, KSHA konstaton pamundësinë për argumentimin e kushtit:

a. anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit/argumentimit të anës ekonomike sipas zerave që përmban çmimi i ofertës së deklaruar. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e konsideron të drejtë vendimin e K VO që operatori ekonomik ankimues ka dështuar në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Konkretisht, në dokumentacionin provës he argumentues për ofertën anomalisht të ulët, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi duke percaktuar edhe çmimet përkatëse. Por konstatohet fakti se subjekti me të cilin është nënshkruar kjo kontratë bashkëpunimi, konkretisht

"IDEA-M" është i ndryshëm nga subjekti prodhues, i deklaruar në katalogun teknik. Pra ky subjekt, "IDEA-M" është referuar në katalog si prodhues vetëm për artikullin me numër rendor (142, 144, 146) dhe jo për të tjerët. Komisioni i Shayrtimit të Ankesave thekson faktin që KVO mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shayrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Ky fakt lidhet drejtperdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. Konkretisht, risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, si:

- rreziku për moskryerjen e shërbimit/furnizimeve në cilesinë e duhur;
- rreziku i terheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit/furnizimit brenda afateve kohore të parashikuara;
- humbjet që mund të pesojë në kohë nga moskryerja e shërbimit/furnizimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Gjithashtu, KSHA thekson se referuar nën 2 germa "b» "Qëllimi" i ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet se: "ëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike he të ulë shpenzimet procedurale". Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen e ofertave me të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar "(mimet me të ulët)", por gjithashtu shmangien e risqeve dhe deshtimin e kontratës, që mund të vinë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formula të përlogaritjes të parashikuara në ligj.

Sa me sipër, KSHA konstaton se operatori ekonomik ankimues ka deshtuar në argumentimin e ofertës së tij anomalisht të ulët. Mosperputhja midis subjektit të deklaruar si prodhues në katalog dhe subjektit me të cilit është paraqitur marrëveshja për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët jo vetëm që tregon një pamundësi për argumentimin e aspektit ekonomik të metodës së përlogaritjes së ofertës ekonomike por tregon gjithashtu edhe një mungesë koherente të procesit të ofertimit në një procedurë prokurimi.

Për më tepër, KSHA konstaton faktin se jo vetëm Eshtë paraqitur një ofertë ekonomike e ulur në mënyrë të pa argumentuar por gjithashtu edhe katalogu teknik i hartuar dhe nënshkruar nga operatori ekonomik ankimues nuk është konform kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, sipas pikës 2.3.8 "Për artikujt për të cilët nuk janë kërkuar mostra (sipas renditjes në shtoiçën nr. 6 "Formulari i specifikimeve teknike"), operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skeda teknike, të leshuara/publikuara nga prodhuesi, ku të evidentohen artikujt e ofruar dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me dokumentet e tenderit.

Katalogët/skeda teknike përpilohen nga prodhuesit në mënyrë standarde dhe deklarative, he përmbajnë ato informacione lidhur me mallrat/produktet përkatëse, që prodhuesi i gjkon të

nevojshme. Pra, permbajja e katalogut nuk Eshte ne diskrecion te operatorit ekonomik pjesëmarres, por 4/shte ne diskrecion total te prodhuesit te produktit. KSHA konstaton se katalogu i paragitur si pjese e procesit te ofertimit permban deklarime te te dh@nave perkatëse elektronike te disa subjekteve, konkretisht adresa ëeb, pa permbatur asnje dokument tjetër provues.

Pra, operatori ekonomik ankimues "LIBRARI DYRRAHU" shpk ka deklaruar ne katalogun e paraqitur, subjektin "IDEA-M" shok si prodhues nga i cili do te mundësoje një pjese të konsiderueshme te artikujve te kerkuar, pa paragitur dokumentacion tjetër mbështetës dhe provues. Në ankesën e paragitur operatori ekonomik ankimues deklaroi se "IDEA-M nuk eshte prodhues por shitës, pra eshte subjekti nga i cili operatori yne ekonomik do te furnizohet... deklarate kjo që perforcon edhe me shume parregullsine e katalogut te paragitur kundreit kerkesave dhe specifikimeve teknike te dokumenteve te tenderit. Per të shmangur këtë artifice ne permbushjen e kriterëve te vecanta te kualifikimit, operatori ekonomik ankimues nese do te kishte paqartesi ne lidhje me plotësimin e e kerkeses lidhur me kataloget teknike, ka pasur ne dispozicion momentin procedural te paragitjes se kerkeses per sqarim prane OPB-së parashikuar nga pika le nenit 75 te LPP-se ku percaktohet se: "I. Ofertuesi i mundshem mund te kerkoje sgarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i pergjigjet do kërkesë per sqarim te dokumenteve te tenderit, te bere nga do operator ekonomik, me kusht ge kerke sa te jete marre jo me vone se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. [.. Per sa me sipër, pretendimi ankimuesit nuk gëndron. PËR KËTO ARSYE

Bazuar ne nenin 114 ligit nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 t VKM-së nr.285/2021 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar per shayrtimin e ankeses,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankeses se paraqitur nga operatori ekonomik "LIBRARI DYRRAHU" SHPK.
[...]

II.5. Në datën 16.05.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5321 si dhe nr. Protokolli 1266/2025 datë 19.05.2025 i operatorit ekonomik "InfoSoft Office" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-38672-02-19-2025, me objekt: Loti 2 - Blerje materiale Kancelarie të tjera zyre", me fond limit 13,757,377.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04-04- 2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1266/1 prot., datë 19.05.2025 lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e për kriteret e përgjithshme të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.2. Me shkresën nr. 632/29 prot., datë 27.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1266/2 prot., datë 29.05.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “InfoSoft Office” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka pranuar pjesërisht atë, me arsyetim si më poshtë:

“[...]

II.1 Lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik "InfoSoft Office" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së OE "LIBRARI DYRRAHU" shpk me pretendimin se: Operatori ekonomik ofertues "LIBRARI DYRRAHU" shpk nuk ka arritur të plotësojë@ piken 2.3.1 të kapacitetit teknik të shtojcës & KSHA

arsyeton

se:

Ne ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Nenit 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 4 parashikohet se: "Në lidhje me aftësitë teknike të profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore të teknike, si të përvetshme të nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë

që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm të përvetshme që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat të zbatuara në të shkuarën". Referuar, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"; ndryshuar, Neni 40 "Kërkesa të vecanta për kontratat të mallrave", pika 4, parashikohet shprehimisht se: "Për të provuar përvetshmenë të mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurimet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvetshmenë të mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvetshmes të mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik "LIBRARI DYRRAHU" shpk ne kuader te permbushjes se kerkeses per deshmimin e punëve te ngjashme te realizuara me sukses, konstaton permbushin kerkesën e percaktuar ne Dokumentet e Tenderit, sipas pikës 2.3.1 "Operatori ekonomik duhet te paragese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gate 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne vleren jo me pak se 40% e vleres se fondit limit te lotit. Keto furnizime te meparshme, te ngjashme, duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte...

.». Ky kriter konsiderohet i permbushur ne te treja aspektet e tij, konkretisht ngjashmerine ne natyre me objektin e procedures se prokurimit, vleren e perlllogaritur si dhe afatin kohor për kryerjen e ketyre furnizimeve gjatë tre viteve te fundit. Ne këtë kontekst, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave e konsideron te permbushur kriterin e sipercituar dhe t@ sakte vler@simin e Komisionit te Vler@simit te Ofertave. Per sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

PER KETO ARSYE

*Bazuar ne nenin 114 ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". i ndryshuar, de nenit 102 te VKM-së nr.285/2021 **Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni l ngarkuar per shqyrtimin e ankeses.*

VENDOSI

1. Pranimin e piessshëm të ankeses se paraqitur nga operatori ekonomik "'InfoSoft Office".

II.6. Me shkresën nr.1216/5 prot, datë 30.06.2025, Komisioni i është drejtuar autoritetit kontraktor , për paraqitjen e informacionit të argumentimit të ofertës anomalisht të ulët me dokumentacionin shoqërues të paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” duke qënë se nga SPE nuk u gjend informacioni i mësipërm.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.632/33 prot., datë 09.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1216/6 prot., datë 10.06.2025, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga autoriteti kontraktor shkresa me objekt “Dërgim informacioni” me informacionin e kërkuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 16.05.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5321 si dhe nr. Protokoli 1266/2025 datë 19.05.2025 i operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38672-02-19-2025, me objekt: Loti 2 - Blerje materiale Kancelarie të tjera zyre”, me fond limit 13,757,377.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04-04- 2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin për kriteret e përgjithshme dhe të vëcanta të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Infosoft Office” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin për kriteret e përgjithshme dhe të vëcanta të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Autoriteti Kontraktor me anë të shkresës nr. 632/29 prot., datë 27.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1266/2 prot., datë 29.05.2025, ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK. Referuar shkresës nr. 632/29 prot., datë 27.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1266/2 prot., datë 29.05.2025, të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur të pranojë pjesërisht, si më poshtë:

Konkretisht autoriteti kontraktor ka pranuar:

“[...]

Il.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "InfoSoft Office" shpk për kundërshtime për operatorin ekonomik "LIBRARI DYRRAHU" shpk me arsyen se nuk ka arritur të ofertoje me produkte të cilat të plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6 të DT-se, konkretisht katalog/skeda teknike jo të paragjitura nga prodhuesi, KSHA arsyeton se:

....

Sa me sipër, KSHA konstaton se operatori ekonomik ankimues ka deshtuar në argumentimin e ofertes se ti anomalisht të ulet. Mospërputhja midis subjektit të deklaruar si prodhues në katalog dhe subjektit me të cilin është paragjitur marr@veshia për iustificimin e ofertes anomalisht të ulet jo vetëm që tregon një pamundësi për argumentimin e aspektit ekonomik të metodës se

per llogaritjes së ofertës ekonomike por tregon gjithashtu edhe një mungesë koherente të procesit të ofertimit në një procedurë prokurimi. Për më tepër, KSHA konstaton faktin se jo vetëm Eshtë paragitur një ofertë ekonomike e ulët në mënyrë të pa argumentuar por gjithashtu edhe katalogu teknik i hartuar dhe nënshkruar nga operatori ekonomik ankimes nuk është konform kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, sipas pikës 2.3.8 "Për artikujt për të cilët nuk janë kërkuar mostra (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 "Formulari i specifikimeve teknike"), operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skeda teknike, të leshuara/publikuara nga prodhuesi, ku të evidentohen artikujt e ofruar dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me dokumentet e tenderit".

Katalogjet teknike, fotografite, apo pershkrimet, shërbejnë për të vertetuar se produktet e ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit.

Katalogjet/skedat teknike përpilohen nga prodhuesit në mënyrë standarde dhe deklarative, dhe përmbajnë ato informacione lidhur me mallrat/produktet përkatëse, që prodhuesi i gjkon të nevojshme. Pra, përmbajja e katalogut nuk është në diskrecion të operatorit ekonomik pjesëmarrës, por është në diskrecion total të prodhuesit të produktit. KSHA konstaton se katalogu i paragitur si pjesë e procesit të ofertimit përmban deklarime të të dhënave përkatëse elektronike të disa subjekteve, konkretisht adresa eëb, pa përmbajtur asnjë dokument tjetër provues.

Pra, operatori ekonomik ankimes "LIBRARI DYRRAHU" shpik ka deklaruar në katalogun e paraqitur, subjektin "IDEA-M" shpik si prodhues nga i cili do të mundësojë një pjesë të konsiderueshme të artikujve të kërkuar, pa paragitur dokumentacion tjetër mbështetës dhe provues. Në ankesën e paraqitur operatori ekonomik ankimes deklaroi se "IDEA-M" nuk është prodhues por shitës, pra është subjekti nga i cili operatori ynë ekonomik do të furnizohet... deklaroi kjo që përforcon edhe me shumë parregullsine të katalogut të paraqitur kundrejt kërkesave dhe specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes gërdon.

PER KETO ARSYE

Bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285/2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës.

VENDOSI

- 2. Pranimin e përsishëm të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "InfoSoft Office".**

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se : *“1.Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

“2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

Për këtë arsye, **KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pjesën e pranuar të ankesës nga autoriteti kontraktor** për ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/5321 si dhe nr. Protokolli 1266/2025 datë 19.05.2025 të operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k. mbi kundërshtimin e kualifikimit të shoqërisë “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k. për kiriteret e vecantë për kualifikim, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.4., gjendja faktike dhe juridike e

operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k. nuk do të ndryshojë duke mbetur i skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.3. Në datën 09.05.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa online me nr. A/2025/5302 dhe protokolluar me nr. 1216/2025, datë 12.05.2025, të operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-38672-02-19-2025, me objekt: Loti 2 - Blerje materiale Kancelarie të tjera zyre”, me fond limit 13,757,377.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04-04- 2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit. Më datë 19.05.2025, operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 1216/2 prot., datë 19.05.2025, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tyre, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit me arsyen se: *Ne kemi dhënë një informacion tepër të detajuar, mbi të gjitha planifikimet që ka bërë kompania, për realizimin e këtij tenderi. Në tërësinë e saj, kërkesa për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët për këtë pikë të nenit 93 pika 2, konsiston në paraqitjen e shpjegimeve mbi ndërtimin e ofertës ekonomike shoqëruar me dokumente provuese, që vërteton mundësinë e OE për të siguruar Ámime nën Ámimet e kuotuar dhe shpjegimi e dokumentacioni provues i paraqitur prej nesh e vërteton këtë. Operatori ynë ekonomik, me përgjegjshmëri, ka bërë kalkulime të sakta, për t'ju përmbajtur detyrimit ligjor që të kuotojë me cmime konkurruese dhe mundësinë reale të ofertës. Oferta jonë nuk mund të jetë kurrsesi e papërgjegjshme apo e papranueshme, edhe pasi janë dhënë të gjitha sqarimet e shoqëruara me prova, vetëm sepse KVO e AK në mënyrë subjektive shprehet se nuk bindet nga sqarimet e dhëna, sepse sipas KVO OE nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët. Pra, në thelb, asnjë nga ádshtjet e konsideruara si shkaqe për mospranim të argumentimit tonë nga KVO e AK nuk qëndrojnë sipas sqarimeve dhe argumentimeve të cituara më lart prej nesh. Për të përforcuar shpjegimet e dhëna më sipër, na lejoni të sjellim në vëmendjen tuaj edhe interpretimin e bërë nga SIGMA në udhëzimin nr. 35 të vitit 2016 i ofertat anomalisht të ulëtaë: idirektiva shprehet se autoritetet kontraktore mund të refuzojnë vetëm një ofertë, kur provat e paraqitura nuk argumentojnë në mënyrë të kënaqshme nivelin e ulët të Ámimit ose të kostos së propozuar, duke marrë parasysh shpjegimet e ofruara nga operatorit ekonomik. Autoriteti kontraktor ka të drejtë vetëm të refuzojë ofertën kua ai ka vendosur, pas hetimeve që oferta është me të vërtetë anomalisht e ulët. Nëse shpjegimet e dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik, të*

cilat autoriteti konteaktor I ka analizuar në konsultim me këtë operator ekonomik, tregojnë se Ámimi (kosto) është e vërtetë, atëherë oferta nuk mund të konsiderohet si ofertë anomalisht e ulët dhe nuk mund të hidhet poshtë.ë. Pra në konkluzion rezulton se shpjegimet e dhëna prej nesh së bashku me provat e shumta shoqëruese, tregojnë se Ámimet e ofertuara janë reale, të mundshme, nuk paraqesin asnjë rrezik për moszbatim të kontratës në kohë dhe cilësi, nuk janë të lidhura me avantazhe të ndihmës shtetërore dhe as nuk ekziston asnjë rrezik që AK përfitues të përballet me kërkesa për rritje të kostove gjatë zbatimit të kontratës, pasi këto Ámime janë fikse dhe të pandryshueshme. Nga ana jonë kemi detajuar analizën e kostos në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe kemi justifikuar Ámimin e ofertuar për Ádo zë (përfshirë cdo kosto). NË këtë kuptim, krijohet bindja se nga ana joën janë përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i lppsë. NË rastin konkret argumentimi i KVO ñsë Arsyetimi për mosargumentimin e kushtit a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara osë të metodës së ndërtimit/argumentimin e anës ekonomike sipas zërave që përmban cmimi i ofertës së deklaruar; NË dokumentacionin e paraqitur në SPE konstatohet se OE ka nënshkruar një akt ñ marrëveshje bashkëpunimi me subjektin IDEA-M shpk, ku do të furnizohet me të gjithë artikujt objekt prokurimi të këtij loti. Nisur nga verifikimi i katalogut të dërguar në SPE, vërehet se OE vetëm për artikujt (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 iformulari i specifikimeve teknikeë në DST, me numër rendor 142. 144. 146, ka deklaruar në katalog linkun Ëeb të subjektit IDEA-M, ku mund të verifikohet specifikimet e artikujve të ofruara, ndërsa për të gjithë artikujt e tjerë OE ka deklaruar në katalog linqe Ëeb të subjekteve të tjera për të cilat nuk disponon asnjë dokumentacion provues bashkëpunimi apo furnizimi. NË këto kushte , KVO konsttaon një mospërputhje midis artikujve të deklaruar në katalog (të subjekteve të tjera) me artikujt e ofruar nga subjekti IDEA-M shpk. Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të nenit 93 pik 2 të Ligjit nr. 162/2020, të mdryshuar dhe arsyetimet e parashtruara më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e operatorit ekonomik ilibrari Dyrrahuë shpk. Dhe asnjë anomali tjetër në paraqitjen e detajuar të analizës së kostos nuk shkakton asnjë nga rreziqet potenciale të sipërcituara. Për aq kohë sa nga ana jonë janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi në rastin konkret, krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST shojcën 8, **2.3 Kapaciteti teknik**, Kriterin **2.3.8** 2.3Për artikujt për të cilët nuk janë kërkuar mostra (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”), operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike, të lëshuara/publikuara nga prodhuesi, ku të evidentohen artikujt e ofruar dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me dokumentet e tenderit.

Dokumentet standarde, F. VLERËSIMI I OFERTAVE

22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht të ulët:

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

(a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

(b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

(c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit:

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

III.3.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së, me shkresën protokolluar me tonën me nr. 632/33, datë 09.06.2025, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët, ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Librari Dyrrahu” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte, KVO sipas shkresës së lartëpërmendur, i është drejtuar operatorit ekonomik me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.3.3. Në përgjigje të kërkesës së KVO- së operatori ekonomik “Librarri Dyrrahu” SHPK, me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresën datë 23.10.2023, me lëndë “Sqarim mbi ofertën anomalisht të ulët/analizë të detajuar të kostos, mbështetur në fatura blerje artikujsh, fletë zhdoganime, oferta të marrë nga furnitorët e tij për këtë procedurë prokurimi.

III.3.4. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:
“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...].”

III.3.5. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”

III.3.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej **9,200,000.00** lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç”, të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis.

Në interpretim literal të nenit 93, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët, njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi, apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfutur ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien

e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.3.7. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit rezulton, se argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik lidhur me argumentimin/sqarimin e ofertës anomalisht të ulët.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi mori në shqyrtim dokumentet e përcjella nga autoriteti kontraktor konstaton, se operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues të argumentimit të ofertës anomalisht të ulët me anë të cilit ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë.

Përveç kësaj, KPP vëren, se operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk në mbështetje të deklarimeve më sipër, me qëllim argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka paraqitur, një analizë për të gjithë artikujt objekt - prokurimi, duke detajuar analizën e kostos të artikujve që ka ofertuar.

Siç u përmend më lart, përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, të shoqëruara me dokumente provuese,

operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të germës a) të nenit 93 të LPP-së, ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës për të gjithë artikujt që merr nga OE të tjerë.

Pra, operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk, ka detajuar analizën e kostos në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe ka justifikuar çmimin e ofertuar për çdo zë.

- OPB LOTI II _formular_oferte_dhe_listë_çmimesh.
- OPB LOTI II _KATALOG.

Gjithashtu, operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, ka argumentuar çmimet e ofertës së tij duke bashkëlidhur:

-Ofertë nga OE “IDEA-M” shpk me çmime për çdo artikull që siguron prej saj.

-Oferte nga OE “Global Grafika” shpk për artikujt që ofron me logo (çmime, shpenzime, dogana.

- Analiza kosto nga OE “IDEA M” shpk.(çmime ,konvertimi i kembimit të kursit euro-lekë, dogana për artikujt e ofruar, shpenzime tjera.

-Analizë kosto nga OE “Global Grafika” shpk.

-Xhiro vjetore të viteve 2021-2024 me vlerat përkatëse të OE “LIBRARI DURRAHU” shpk.

Elemente të tjera favorizuese në përmbushje të kushtit për zgjedhje teknike të favorshme, si eksperiencia e gjatë në treg me aktivitet të gjatë:

-Realizime me sukses të shumë kontratave të ngjashme në kohë dhe me cilësi (cituara në materialin e operatorit ekonomik).

Punë të ngjashme paraqitura edhe në këtë procedurë.

Për sa i përket c) *origjinalitetit të punëve, mallrave dhe shërbimeve propozuar nga ofertuesi*, artikujt e ofruar nga ne janë sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001 për cilësinë dokumente të paraqitura në këtë procedurë prokurimi.

ç) *pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës*; Kompania jonë plotëson të gjitha detyrimet ligjore, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore apo edhe certifikimet sipas standardeve.

-ISO 9001 Për Menaxhimin e cilësisë dhe Sigurinë,

-ISO 14001 Për Sistemin e Menaxhimin e Mjedisit.

Për të sqaruar në lidhje me pikën d) *mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore*, operatori jonë ekonomik nuk e ka të nevojshme.

Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë të fakteve gjykon, se ankimuesi ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së i ndryshuar, duke argumentuar në mënyrë bindëse të gjitha elementet e ofertës së tij dhe duke analizuar në mënyrë të detajuar secilin prej tyre.

Argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t’i përmbahen zbatimit të kontratës, duke ofruar shërbime/ punë/ mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Komisioni sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/punës/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet sipas parashikimeve të lex specialis për prokurimin publik.

III.1.8. Përsa i përket argumenteve të Autoritetit Kontraktor:

Arsyet e skualifikimit:

[...]Në dokumentacionin e paraqitur në SPE konstatohet se OE ka nënshkruar një aktmarrëveshje bashkëpunimi me subjektin “IDEA-M” sh.p.k, ku do furnizohet me të gjithë artikujt objekt prokurimi te këtij loti. Nisur nga verifikimi i katalogut të dërguar në SPE, vërehet se OE vetëm për artikujt (sipas renditjes në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike” të DST), me nr. rendor 142 , 144 , 146, ka deklaruar në katalog linkun ëeb të subjektit “IDEA-M” , ku mund të verifikohet specifikimet e artikujve të ofruara , ndërsa për të gjithë artikujt e tjerë OE ka deklaruar në katalog linqe ëeb të subjekteve të tjera për të cilat nuk disponon asnjë dokumentacion provues bashkëpunimi apo furnizimi. Në këto kushte, KVO konstaton një mospërputhje midis artikujve të deklaruar në katalog (të subjekteve të tjera) me artikujt e ofruar nga subjekti “IDEA-M” sh.p.k. Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, të ndryshuar dhe arsyetimet e parashtruara më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se operatori ekonomik nuk e ka 3 argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SH.P.K, me NUIS L91418502J.”
[...]

Dhe argumentet e përdorura nga KSHA:

Per me teper, KSHA konstaton faktin se gjithashtu edhe katalogu teknik i hartuar dhe nenshkruar nga operatori ekonomik ankimues nuk është konform kërkesave të percaktuara ne dokumentet e tenderit, sipas pikës 2.3.8 "Per artikuajt per te cilet nuk jane kerkuar mostra (sipas renditjes ne shtoiçën nr. 6 "Formulari i specifikimeve teknike"), operatori ekonomik duhet te paragese katalog/skede teknike, te leshuara/publikuara nga prodhuesi, ku te evidentohen artikuajt e ofruar dhe specifikimet korresponduese, me gëllim verifikimin e perputhshmërise se tyre me dokumentet e tenderit

Kataloget teknike, fotografite, apo pershkrimet, sherbejne per te vertetuar se produktet e ofruara nga operatorët ekonomike pjesëmarres, plotësojne kerkesat e vendosura ne dokumentet e tenderit.

Katalogët/skedat teknike perpilohen nga prodhuesit ne menyre standarde dhe deklarative, he permbajne ato informacione lidhur me mallrat/produktet perkatese, qe prodhuesi i gykon te nevojshme. Pra, permbajja e katalogut nuk Eshte ne diskrecion te operatorit ekonomik pjesëmarres, por 1/3shte ne diskrecion total te prodhuesit te produktit. KSHA konstaton se katalogu i paragitur si pjese e procesit te ofertimit permban deklarime te te dhënave perkatese elektronike te disa subjekteve, konkretisht adresa ëeb, pa permbatur asnje dokument tjeter provues.

Komisioni në shqyrtim të arsyes së skualifikimit nga KVO, gjykon se autoriteti kontraktor, në fazën e vlerësimit të ofertave duhej të analizonte përmbushjen e kriterit 2.3.8. dhe në çdo rast në referim të nenit 92 “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ...Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, për një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm të ofertave, duhej të kërkonte sqarime mbi përmbushjen e kriterit kualifikues përpara se të kalonte në vlerësimin e anës ekonomike të ofertës së ankimuesit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Librari Dyrrihu” SHPK qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor dhe të mos marrë në shqyrtim pjesën tjetër të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-24709-10-15-2024, me objekt "Blerje materialesh kancelarie për një periudhë 24 mujore, e ndarë në lote”, Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 36,963,400.40 Lekë pa TVSH, Numri i referencës së Lotit 1: REF-24718-10-15-2024 me objekt: “Loti 1 – Blerje materiale Kancelarie me bazë letre”, me vlerë totale 5,857,217.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.11.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi si dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për operatorin ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” Shpk.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” Shpk & “LIBRARI DYRRAHU” Shpk.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fioorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri